



Foto Vera Hartmann Gockhausen

A i nevojiten fëmijëve të vegjël mediat në ekran?

Një botim nga Elternbildung CH

mbështetur nga Victorinox dhe
programi kombëtar Rinia dhe Mediat



Fëmijët e vegjël kanë nevojë për hapësira jetese pa ekran!

Fëmijët për zhvillimin e tyre kanë nevojë për përkushtim emocional, vëmendje dhe bashkëbisedim me një person përkujdesës. Shtimi i kontaktit të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël me mediat në ekran do të thotë një sfidë e madhe për prindërit dhe kërkon një trajtim të ndjeshëm.

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël reagojnë ndaj mediave në ekran

Fëmijët e vegjël, kalimthi, marrin shumë nga përdorimi i mediave nga ana e familjes, ngaqë mediat në ekran janë pjesë e përditshmërisë së një familjeje.

Shpesh të vegjlit përjetojnë, që më shumë vëmendje u përkushtohet pajisjeve sesa atyre. Prandaj kujdesuni për një përdorim të përgjegjshëm të mediave:

- mos lejoni që vazhdimisht të shpërqendroheni nga celulari juaj.
- mos vizitoni internetin në praninë e fëmijës tuaj.
- jepini vetes një pushim nga mediat, kur dilni me fëmijën tuaj.
- mos e angazhoni dhe mos e qetësoni fëmijën tuaj me mediat në ekran.

Fëmijët kanë nevojë për

- vëmendje të pandarë dhe kontakt me sy.
- marrëdhënie të besueshme.
- pushim dhe relaksim.
- përvojë personale.
- liri të plotë të lëvizjes dhe ajër të pastër.

Duke luajtur mëson me të gjitha shqisat dhe nxit zhvillimin e përgjithshëm

Në shtëpi ekzistojnë shumë gjëra tërheqëse, të cilat mund të përshtaten për të luajtur.

Fëmija e vogël mundet për shembull:

- një shishe plastike ta mbushë me kapëse rrobash.
- të luajë me lugë dhe një tigan të vjetër.
- të merret me një mbërthyes nga ndonjë veshje e vjetër.
- Kuti kartoni me madhësi të ndryshme ti vendose një mbi një, ose brenda njëri tjetrit, ose ti mbushë dhe ti zbraze.
- etj.

Jashtë ekzistojnë gjithashtu shumë gjëra interesante, të cilët i ngacmojnë dhe i zhvillojnë - të gjitha shqisat - dëgjimin, shikimin, nuhatjen, shijen dhe prekjen, për shembull:

- të përpiqet, ti vendose një mbi një gurët e mëdhenj.
- të nuhasë aromën e drurit dhe copën e lëvores së vjetër dhe gjetheve të thata.
- të prekë dhe ta ndjeje sipërfaqen e bukur dhe të lëmuar të gështenjes sapo të rënë.
- të gërmojë në rërë (ose baltë).
- të vëzhgojë dhe ta prek një krimb shiu.
- etj.

Kjo fletushkë u krijua në bashkëpunim me Njësinë për parandalimin e varësive të qytetit të Cyrihut, Zyrrën për çështjen e fëmijëve Cyrih me ekspertë të ndryshëm dhe në bashkëpunim me Asociacionin zviceran për këshillimin e nënave

Lexim i rekomanduar

jugendundmedien.ch përmbledh njohuritë mbi mundësitë dhe rreziqet nga mediat digjitale. Prindërit, mësuesit dhe personat përkujdesës në platformën e internetit të programit kombëtar **Rinia dhe Mediat** do të gjejnë Informata dhe oferta për këshilla në afërsinë tuaj.



elternbildung.ch

Elternbildung CH
Steinwiesstrasse 2
8032 Zürich
Tel. 044 253 60 60

info@elternbildung.ch
www.elternbildung.ch



Stadt Zürich
Suchtpräventionsstelle

